



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 09/2018**

24 tetor 2018

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

- Rregullore nr. XX/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 28 gusht deri me 10 tetor 2018.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që:

“AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në rastin e kësaj rregulloreje konsultimi publike me palët e interesuara, u realizua sipas pikës 5.1, a) të udhëzimit të lartëcekur.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i janë përgjigjur dy persona fizik, të cilët kanë paraqitur vërejtjet/sugjerimet e tyre nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për projekt-rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur vërejtjet/përgjigjet e AAC-së, si dhe ndërhyrjet në tekst të projekt-rregullores, aty ku është konsideruar relevante.

Radhitja e shqyrtimit të komenteve/sugjerimeve është bërë në bazë të radhitjes kalendarike të pranimit të komenteve dhe/ose sugjerimeve nga palët, nëpërmes adresës elektronike.

1. “Neni 1. pika 1.2, paragrafi b)...lidhur me shënjimin dhe ndriçimin e pengesave – (është mirë të ceket) sipas Rregullores- 02/2010, me Plotesimet dhe Ndryshimet Nr.02/2013. Në bazë të praktikave të ndertimit të Largpërquesve, KOSTT gjithnjë ka përfill Kriteret e Rregulloreve në fuqi.”

(Dërguar nga Astrit Beqa, KOSTT-Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a., dt. 11 shtator 2018, ora 14:31 min).

1. Përgjigje e AAC-së:

Në nenin 2 “Përkufizimet dhe interpretimet” është dhënë përkufizimi i termit “pengesë”, kurse për qëllim të kësaj rregulloreje, do të shohet përkufizimi për termin “Shënjimi dhe ndriçimi i pengesave”:

“Shënjimi dhe ndriçimi i pengesave” nënkupton shenjimin e pengesave me shenja vizuale dhe drita, në territorin e Republikës së Kosovës, me qëllim që ato të bëhen të dallueshme për avionët në fluturim”.

2. **“Poashtu, paragrafi c)...shfrytëzimin e tokave -(të ceket) për Bujqësi/Pylltari.”**

(Dërguar nga Astrit Beqa, KOSTT-Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a., dt. 11 shtator 2018, ora 14:31 min).

2. Përgjigje e AAC-së:

Neni 1, pika 1.2 nën c) i Projekt-Rregullores thotë:

“c) rreziqet që lidhen me aktivitetet njerëzore dhe shfrytëzimin e tokës në mënyrë që, sipas nevojës, të ndërmerrë veprime brenda kompetencave të tij.”

Operatori i aerodromeve duhet të monitoroj të gjitha rreziqet që lidhen me shfrytëzimin e tokës pavarësisht për çfarë qëllimi përdoret toka.

3. **“Neni 6. (Përrjashtimet)!...AAC-ja nuk duhet të lejoj asnjë përjashtim, meqë nuk ka asnjë Urgjencë më te madhe se jeta e njerzve, sidomos kur gjenden në AJËR, kur bëhet fjalë për Transportin e mallrave, atëhere është tjetër muhabet!”**

(Dërguar nga Astrit Beqa, KOSTT-Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a., dt. 11 shtator 2018, ora 14:31 min).

3. Përgjigje e AAC-së:

Neni 6 “Përrjashtimet” i Projekt-Rregullores thotë:

“AAC-ja mund të lejojë përjashtime nga kërkesat e kësaj Rregulloreje nëse konstaton se një veprim i tillë do të ishte në interesin urgjent publik dhe nuk do të rrezikonte sigurinë e aviacionit civil.”

Me këtë nen veçse është e theksuar që AAC-ja mund të lejoj ndonjë përjashtim nga kjo Rregullore vetëm nëse nuk cenohet siguria e aviacionit civil.

4. "Article 1

1.2 The aerodrome operator shall monitor on the aerodrome and its surroundings:
a) for obstacle limitation and protection surfaces as established in accordance with the certification basis, and other surfaces and areas associated with the aerodrome, in order to take, within its competence, appropriate action to mitigate the risks associated with the penetration of those surfaces and areas;
b) for marking and lighting of obstacles in order to be able to take action within its competence, as appropriate; and
c) for hazards related to human activities and land use in order to take action within its competence, as appropriate."

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

4. Përgjigje e AAC-së:

Neni 1, Pika 1.2 në gjuhen shqipe do të korrigohet dhe do të jetë si vijon:

"1.2 Operatori i aerodromit duhet të monitoroj në aerodrom dhe në hapësirën përreth tij:

- a) sipërfaqet për kufizimin e pengesave të përcaktuara në përputhje me bazën e certifikimit, dhe sipërfaqet dhe zonat e tjera që lidhen me aerodromin, në mënyrë që, në kuadër të kompetencave të tij, të marrë masat e duhura për të zbutur rreziqet që lidhen me penetrimin e këtyre sipërfaqeve dhe zonave;*
- b) shënjimin dhe ndriçimin e pengesave në mënyrë që, sipas nevojës, të jetë në gjendje të ndërmarrë veprime brenda kompetencave të tij; dhe*
- c) rreziqet që lidhen me aktivitetet njerëzore dhe shfrytëzimin e tokës në mënyrë që, sipas nevojës, të ndërmerrë veprime brenda kompetencave të tij."*

Versionet në gjuhen angleze dhe serbe do të mbesin të pandryshuara.

5. "Article 2

Add ANSA in the definitions list"

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

5. Përgjigje e AAC-së:

Neni 2 "Përkufizimet dhe interpretimet" do të plotësohet me kete përkufizim:

"“ASHNA” nënkupton Agjencinë për Shërbimet e Navigacionit Ajror i Republikës së Kosovës".

6. "Article 3

3.2 Aerodrome Operators CAAs or ANSA are required to define the Aerodrome Protective Zone for the aerodrome they operate in accordance with the standards and requirements of Regulation No. 17/2017 and Annex 14 to the Chicago Convention as appropriate. These zones shall be laid down in a Safeguarding Map which shall be accepted and approved by the CAA and made available to the relevant Ministry and Municipalities."

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

6. Përgjigje e AAC-së:

Neni 3, pika 3.2 do të ndryshohet si vijon:

"Operatorët e aerodromeve duhet të definojnë Zonën Mbrojtëse të Aerodromit të cilin e operojnë, në përputhje me standardet e Rregullores Nr. 17/2017 dhe Aneksit 14 të Konventës së Çikagos për përcaktim të Sipërfaqeve për kufizimin e pengesave (SKP). Këto zona duhet të skicohen në një Hartë Mbrojtëse e cila duhet të pranohet dhe të miratohet nga AAC dhe e cila duhet të vihet në dispozicion të Ministrisë dhe Komunave përkatëse."

7. "Article 4

4.3 Aerodrome operator shall assess received data for the construction permit within the scope of paragraph 1, against the following criteria:

- a) Obstacle Limitation Surfaces;
- b) Potential to attract wildlife

Air Navigations Services Agency shall assess received data for the construction permit within the scope of paragraph 1, against the following criteria:

- a) Effects on Visual and Electronic Aids to Air Navigation;"

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

7. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4, pika 3 ndryshon si vijon:

"4.3 Operatori i aerodromit duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Sipërfaqet për kufizimin e pengesave;
- b) Mundësisë për tërheqje të pranisë së zogjve.

Njëkohësisht, operatori i aerodromit duhet të dërgoj të dhënat relevante tek ASHNA për vlerësim të sigurisë në fushëveprimin e tyre.

4.4 ASHNA duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

a) Efektet në ndihmesat elektronike dhe vizuele për navigacion ajror.”

8. **“4.4 Aerodrome operator and Air Navigations Services Agency shall within 15 days upon receiving the data review and provide its final assessment with substantiated reasoning to the CAA by stating any of the following findings:**
- a) no objection with regards to any point of paragraph 3;**
 - b) no objection, subject to certain conditions duly stated;**
 - c) objection, with regard to any point of paragraph 3.”**

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP “Adem Jashari”, dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

8. Përgjigje e AAC-së:

Neni 4, pika 4 bëhet pika 5 dhe ndryshon si vijon:

“4.5 Operatori i aerodromit dhe ASHNA duhen brenda 15 ditëve , pas marrjes së aplikacionit, të shqyrtojnë dhe të japin vlerësimin final të arsyetuar substancialisht tek AAC, duke theksuar ndonjërin nga këto gjetje:

- a) Pa vërejtje, lidhur me ndonjë pikë të paragrafeve 3 dhe 4;*
- b) Pa vërejtje por me disa kushte, të theksuara në mënyrë të duhurë ose*
- c) Me vërejtje, lidhur me ndonjë pikë të paragrafeve 3 dhe 4.”*

9. **“The draft regulation No.XXXX on Aerodrome Protective Zones puts a huge responsibility to the Aerodrome Operator (a private company) and there is either very few responsibilities put to the government agencies including ANSA. According to the Doc 9157 Chapter 2, clause 2.2. there should be more responsibilities distributed to the government agencies!**
- We believe that when the regulation was initially written Aerodrome and Air Navigation Services were one body and under one umbrella therefore the wording aerodrome operator was fit for the task however with the change and separation of these two bodies, the impression is that all responsibilities are left with the aerodrome operator. We do kindly ask from the CAA to take into consideration this issue and update the regulation in accordance with this change.**
- We also think that publication of ICAO Type A and B maps is rather responsibility of government agencies than responsibility of the private operator!”**

(Dërguar nga Burim Zogjani, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP “Adem Jashari”, dt. 11 shtator 2018, ora 15:26 min).

9. Përgjigje e AAC-së:

Qëllimi primar i kësaj Projekt rregulloreje është të mbrojë dhe kontrollojë zonën përreth aeroporteve, në mënyrë që ndërtimet në këto zona të mos e bëjnë aeroportin të pasigurt për operim, pavarësisht a operohet nga operatori privat apo shtetëror.

Për më tepër demonstrimi i përputhshmërisë me 'Rregulloren Nr. 17/2017 Për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet' lidhur me krijimin dhe monitorimin e sipërfaqeve për kufizimin dhe mbrojtjen nga pengesat ,nga ana e operatorit të aerodromit, është një nga parakushtet për certifikim të aerodromit sipas kësaj rregulloreje.

10. **Neni 1 Fusha e zbatimit paragrafit 1.1 referenca në "Ligjit për Ndërtimtari" të zëvendësohet me Ligji per ndertim ne fuqi**

(Dërguar nga Xhemail Metolli, MMPH, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Pranohet. Të përmirësohet referenca dhe te referohet Ligjit 04/L-110 për ndërtim.

11. **Neni 2 Përkufizimet dhe interpretimet**

Komenti rreth përkufizimit "Aerodrom"- Ne ligjin e ndertimit nr 04/L-110 eshte perdorur termi AEROPORT, propozoj qe te perdoret e njejta terminologji nese jemi duke folur per te njetin subjekt (une po mendoj se po per faktin se edhe ne fjalorin shqip -shqip nuk ka ndonje ndyshim te madh)

(Dërguar nga Xhemail Metolli, MMPH, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Termi "Aerodrom" përdoret sipas Ligjit për aviacionin civil.

12. **Komenti në përkufizimin "Ministria/të" referenca në Ligjin Nr. 2004/15 për Ndërtim - Ky ligj është i shfuqizuar. Ju lutem referojuni ligjit nr. 04/L-110 për ndërtimin**

(Dërguar nga Xhemail Metolli, MMPH, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Pranohet. Të përmirësohet referenca dhe te referohet Ligjit 04/L-110 për ndërtim

13. **Neni 3 Dispozitat e përgjithshme 3.2 Operatorët e aerodromit duhet të definojnë Zonën Mbrojtëse të Aerodromit (Formulimi të harmonizohet sipas komentit ME pare)**

(Dërguar nga Xhemail Metolli, MMPH, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Termi "Aerodrom" përdoret sipas Ligjit për aviacionin civil.

14. **Neni 4 Aplikacionet për leje ndërtimi- Procedurat dhe afatet per dhenie te lejes se ndertimit jane te caktuara me Ligjin nr04/L-110 për ndertim dhe Udhëzimi Administrativ ne fuqi per procedurat per kushte ndertimore dhe Leje ndertimore per Objektet e Kategorise se trete andaj eshte mire që kjo Rregullore te harmonizohet me kete Ligj.**

(Dërguar nga Xhemail Metolli, MMPH, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Kjo rregullore nuk nderhynë ne procedurat per leshimin e lejes se ndertimit te percaktuara me Ligjin 04/L-110 për ndërtim

15. Po ju përcjell këtë skicë ku figuron zona kadastrale ku ka qenë aktiv Aeroporti Bujqësor në Komunën e Drenasit. Ky Aeroport pushoi së qenuri aktiv nga koha e pas luftës.

Rreth adresimit të rregullores, si dhe thirrjes për konsultimin publik të palëve të interes mbi këtë rregullore, po ju kërkoj informatën se nëse rregullorja në fjalë do gjejë zbatim edhe në këtë zonë.

(Dërguar nga Aurora Berisha, KK Drenas, dt. 05 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Rregullorja NR. XXXX mbi zonat mbrojtëse të aerodromit" nuk është e zbatueshme për aerodrome të cilat nuk janë operacionale (pra të certifikuara apo aprovuara). Pasi që Aeroporti bujqësor në Komunën e Drenasit nuk është operacional atëherë kjo Rregullore nuk implementohet për aeroportin në fjalë. Nëse institucionet relevante (Komuna apo Ministrinë përkatëse) në të ardhmen në planet e tyre zhvillimore planifikojnë operacionalizimin e tij apo ndërtimin e aerodromeve tjera të ndryshme, atëherë kjo rregullore do të jetë e aplikueshme për ato zona.

16. Neni 1.2 (a) - (operatori nuk ka kompetenca ekzekutive mendoj qe duhet cekur qe operatori te informon Autoritetet kompetente (Ministrin, Komunat;

Neni 1.2 (b) -(operatori nuk ka kompetenca ekzekutive mendoj qe duhet cekur qe operatori te informon Autoritetet kompetente (Ministrin, Komunat;

Neni 1.2 (c)- (operatori nuk ka kompetenca ekzekutive mendoj qe duhet cekur qe operatori te informon Autoritetet kompetente (Ministrin, Komunat;

(Dërguar nga Nexhat Xhigolli, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Obligimi i operatorit është të monitoroj hapësirën e përcaktuar të aerodromit duke i respektuar kriteret nga Neni 1.2 dhe te ndërmerr ato masa që i ka në kuadër të kompetencave të tij.

17. Neni 3.5 (c) - (mendoj se ne vend te siperfaqeve te larta dhe reflektuese, duhet te jete siperfaqe te medha dhe reflektuese);

(Dërguar nga Nexhat Xhigolli, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP "Adem Jashari", dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Pranohet. Do te korrigojohet sipas propozimit.

18. Ne draft rregullore nuk janë përfshirë rastet kur ndertimet fillojnë pa aplikim apo marrje të lejes paraprake ndertimore ne Komuna/ apo Ministri. Si duhet vepruar ne si operator , pasi ne praktike ka shume raste te tilla.

(Dërguar nga Nexhat Xhigolli, LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP “Adem Jashari”, dt. 08 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Operatorit i aerodromit obligohet të monitoroj hapësirën në aerodrom dhe përreth dhe të sigurohet që ndërtimi i identifikuar nuk paraqet rrezik për operimet ajrore pa paragjykuar se a ka leje paraprake ndërtimi i identifikuar.

19. Neni 4, pika 2

Ne verzionin fillestar:

"4.2 Ministria dhe Komunitetet duhet që brenda afatit të arsyeshëm, të dërgojnë të dhënat relevante nga aplikacioni për ndërtimin tek operatori i aerodromit së bashku me të gjitha informacionet e duhura të bashkangjitura me të."

ASHNA mendon që duhet të ndryshohet si:

"4.2 Ministria dhe Komunitetet duhet që brenda afatit të arsyeshëm, të dërgojnë të dhënat relevante nga aplikacioni për ndërtimin tek operatori i aerodromit dhe ASHNA, së bashku me të gjitha informacionet e duhura të bashkangjitura me të."

(Dërguar nga Izedin Ademi, ASHNA dt. 10 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Vlerësimi i ASHNA-së është esencjal për operatorin e aerodromit, pasi sipas Rregullores 17/2017 operatori i aerodromit është përgjegjës të monitorojë aerodromin dhe hapësirë përreth dhe pastaj të vlerësoj ndikimin e objekteve të identifikuar në siguri të operimeve ajrore. Po ashtu, edhe në rast të vlerësimit të ndërtimit të ri, është obligimi i operatorit të aerodromit të sigurohet se një ndërtim i ri nuk paraqet asnjë rrezik për operime, qoftë ai i identifikuar pas vlerësimit nga ASHNA apo operatori i aerodromit.

20. Neni 4, pika 3

Ne verzionin e përditësuar, pas komenteve të B. Z. (LIMAK Kosovo International Airport J.S.C., ANP “Adem Jashari”):

"4.3 Operatori i aerodromit duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Sipërfaqet për kufizimin e pengesave;**
- b) Mundësisë për tërheqje të pranishme të zogjve.**

Njëkohësisht, operatori i aerodromit duhet të dërgoj të dhënat relevante tek ASHNA për

vlerësim të sigurisë në fushëveprimin e tyre."

ASHNA mendon qe operatori i aerodromit nuk duhet te dergoje te dhenat tek ASHNA pasi qe te njejetat duhen derguar paralelisht nga autoriteti perkates (Ministria, Komunat apo edhe AACK) te te dy entitetet dhe duhet te ndryshohet si:

"4.3 Operatori i aerodromit duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Sipërfaqet për kufizimin e pengesave;**
- b) Mundësisë për tërheqje të pranishme të zogjve."**

~~Njëkohësisht, operatori i aerodromit duhet të dërgoj të dhënat relevante tek ASHNA për vlerësim të sigurisë në fushëveprimin e tyre.~~

(Dërguar nga Izedin Ademi, ASHNA dt. 10 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Refuzohet. Njejtë si përgjigja më lartë.

21. Neni 4, pika 4

Ne verzionin e perditesuar, pas komenteve:

"4.4 ASHNA duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Efektet në ndihmesat elektronike dhe vizuele për navigacion ajror."**

ASHNA mendon qe duhet te ndryshohet si:

"4.4 ASHNA duhet të vlerësojë të dhënat e pranuar, brenda fushëveprimit të paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Efektet në ndihmesat elektronike dhe vizuele për navigacion ajror;**
- b) Efektet në trajektorët e fluturimeve dhe sektoret e vektorimit me radar."**

(Dërguar nga Izedin Ademi, ASHNA dt. 10 tetor 2018).

Përgjigje e AAC-së:

Pranohet. Do të korrigjohet sipas propozimit.

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloren, janë vlerësuar gjithsejt 21 vërejtje/komente me shkrim të cilat janë pranuar nga data 28 gusht deri me 10 tetor 2018.

Nga këto vërejtje/komente, AAC-ja ka pranuar pjesërisht apo tërësisht dhjetë (10) vërejtje për adaptim/përmirësim të tekstit të rregullores (komentet nr. 1, 4, 5, 6, 7,8, 10, 12,17 dhe 21) të



cilat do të inkuorohen në verzionin përfundimta të projekt-rregullores. Të gjitha komentet tjera kanë marrë përgjigjet adekuatë.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Aerodromeve
Zyra për Çështje Ligjore të Aviacionit